# DËSHMI ARKIVI

**A-467144**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Duhet të jesh me Ergys Agasin që të ecësh përpara”, aktivistja e arrestuar gjatë protestës tek Kuvendi tregon çfarë u tha policëve |
| ADRESA | `https://versus.al/aktualitet/duhet-te-jesh-me-ergys-agasin-qe-te-ecesh-perpara-aktivistja-e-arrest-i47110` |
| BURIMI | versus.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 19:27:29 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 19:13:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3d468c22ba0f52e15ecf956de54dc9aba47a36fd6230ce2e31badf219c1d9416` |
| TEKSTI | `a20eeb1fdf0257e774b48eda12e1715f5783fb84101f0c1b30c981a1b006cf09` |
| PAMJA | `5f5a4cfb0ee239b701e749383158f98e8d21ebc3530535e1c1a0fc8f41f5dbd9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `807142080cc43be0493cc59964d6212ce5afafc42757c6df495e79beab7db6b7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c406e3f4a37e76aa776ac36276272ef42aa1461296b5cb3dea2e85e36f4d98cc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/807142080cc43be0493cc59964d6212ce5afafc42757c6df495e79beab7db6b7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Vlora Hyseni lihet në arrest shtëpie, GJKKO nuk publikon vendimin deri në fund të hetimeve. Javën e ardhshme pritet mbledhja e Këshillit të Sigurisë]

24 Shtator 2026, 14:07

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në



Created and monetized by

AKTUALITET / 24 Shtator 2026, 21:13

# “Duhet të jesh me Ergys Agasin që të ecësh përpara”, aktivistja e arrestuar gjatë protestës tek Kuvendi tregon çfarë u tha policëve

Koleci përmendi në fjalën e saj edhe emrin e Ergys Agasit, duke thënë se, sipas saj, për të ecur përpara në Shqipëri duhet të jesh në krah tij.

Shkruar nga Versus

Shkruar nga Versus



Një prej aktivisteve të arrestuara gjatë tensioneve të paradites para Kuvendit, Loreta Koleci, ka folur në protestën e 117-të, e zhvilluar para Kryeministrisë.

Gjatë fjalës së saj nga podiumi, Koleci tha se gjatë shoqërimit në komisariat u kishte deklaruar efektivëve të policisë se qytetarët po kërkohen të zbatojnë ligjin në një kohë kur, sipas saj, institucionet shtetërore nuk funksionojnë.

“Dua të them atë çfarë i thashë policisë. Ju kërkoni të zbatojmë ligjin kur i tërë shteti ka rënë. Nuk njihet më kush është polici, kush është krimineli, kush është kryeministri”, u shpreh ajo.

Koleci përmendi në fjalën e saj edhe emrin e Ergys Agasit, duke thënë se, sipas saj, për të ecur përpara në Shqipëri duhet të jesh në krah tij.

“Duhet të jesh ose me Ergys Agasin, ose me Belinda Ballukun. E nuk e kemi fare të drejtën të protestojmë dhe të kërkojmë një Shqipëri më të drejtë dhe të ndershme”, deklaroi aktivistja.

Ajo theksoi se kritikat e saj nuk janë të drejtuara ndaj efektivëve të policisë në mënyrë individuale, por ndaj strukturës së policisë dhe mënyrës se si, sipas saj, është përdorur.

“Nuk e kemi me policinë me emra, por me strukturën që është përdorur për bandat kriminale”, tha Koleci.

Më tej, aktivistja e cilësoi situatën si përgjegjësi jo vetëm të qeverisë aktuale, por edhe të qeverive të mëparshme.

“Nuk është turpi i vetëm i qeverisë, por i qeverive të tëra. Kanë treguar sa antishqiptarë janë”, u shpreh ajo.

Duke iu referuar protestës së 117-të, Koleci tha se pjesëmarrësit do të vijojnë të kërkojnë, sipas saj, të drejtën për të jetuar me dinjitet, pavarësisht presioneve dhe deklaratave politike.

“I thashë dhe që është dita e 117. Kemi treguar se as intimidimet, as patronazhistët, as deklarata e Ramës nuk na ndalin të kërkojmë të drejtën tonë për të jetuar dinjitetshëm. Nuk keni pranga për të gjithë”, përfundoi ajo.**/Versus.al**

Poll



AKTUALITET

["150 euro për një orë. Kemi shumë vajza"/ Zbardhen bisedat, eskortat bëjnë namin në Shqipëri. Ja qytetet e preferuara]()

24 Shtator 2026, 20:39

^ekstrakti^





AKTUALITET

[Protesta e 117-të para Kryeministrisë/ Aktivistët thirrje shqiptarëve në SHBA: Priteni me vezë para OKB-së]

24 Shtator 2026, 20:21

^ekstrakti^



AKTUALITET

[EMRI/ Itali, po kryente punime, bie në gropën e ashensorit 51-vjeçar shqiptar. U zbulua nga zilja e celularit]

24 Shtator 2026, 19:53

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Aksident në Jonufër të Vlorës/ Përplasen dy automjete, plagosen dy persona]

24 Shtator 2026, 19:38

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Atentat në Selanik/ Qëlluan me armë zjarri ndaj 32-vjeçarit por nuk e plagosën. Policia greke arreston 3 shqiptarë]

24 Shtator 2026, 18:28

^ekstrakti^





AKTUALITET

[3 vjet nga sulmi në Banjskë, BE: Keqardhje që Serbia s'ka ndërmarrë hapat e nevojshëm]

24 Shtator 2026, 18:22

^ekstrakti^




AKTUALITET

[Sarandë, 63-vjeçari u godit me shkop, përfundon i intubuar në Tiranë. "Arrest në shtëpi" për të dyshuarin]

24 Shtator 2026, 18:01

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Arrestimi i ish-kreut të SHISH, mblidhet javën e ardhshme Këshilli i Sigurisë Kombëtare]

24 Shtator 2026, 17:52

^ekstrakti^

[Të fundit]




AKTUALITET

**“Duhet të jesh me Ergys Agasin që të ecësh përpara”, aktivistja e arrestuar gjatë protestës tek Kuvendi tregon çfarë u tha policëve**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.